



3A-PROFILE SH.P.K.
Tel./Fax. : +355 48 52 02 22
Cel. : +355 69 2066419
email: info@3a-profile.com



3A-PROFILE sh.p.k

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 06 Mars 2007

Numri unik i indentifikimit(NIPT): K 71704022 V

Adresa e Selise: Vaqarr, Tiranë

Objekti tregtar: Shërbime ndertimi në konstruksione metalike

Pasqyrat Financiare 2012

(Mbyllur më 31.12.2012)

Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2012 deri më 31.12.2012

Data e mbylljes: 20 shkurt 2013

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: në leke

Tiranë, Shkurt 2013

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	0
B. BILANCI KONTABEL	2
C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	4
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA	5
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	6-13



Bilanci kontabël

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012

(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti raportues 31.12.2011
A AKTIVET			
I Aktive Afatshkurtera			
Aktive monetare	3	3,921,537	7,185,502
Derivatë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-	-
Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	142,288,250	132,824,031
Inventari	5	34,736,263	53,009,709
Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		-	-
Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		180,946,050	193,019,242
II Aktive Afatgjata			
Investimet financiare afatgjata		-	-
Aktive afatgjata materiale	6	29,107,609	8,496,192
Aktivët afatgjata jomateriale		-	-
Kapital aksionar i papaguar		-	-
Aktive të tjera afatgjata		-	-
Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		29,107,609	8,496,192
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		210,053,659	201,515,434
B DETYRIMET DHE KAPITALI			
I Detyrime Afatshkurtera			
Huamarrjet		-	-
Huatë dhe parapagimet	7	80,814,235	88,975,521
Grantet dhe të ardhurat e shtyra	7	20,815,360	37,800,944
Provizionet afatshkurtra		-	-
Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		101,629,595	126,776,465
II Detyrime Afatgjata			
Huatë afatgjata	8	31,897,578	17,355,167
Huamarrje të tjera afatgjata		-	-
Provizionet afatgjata		-	-
Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		31,897,578	17,355,167
Totali i Detyrimeve (I+II)		133,527,173	144,131,632
III Kapitali			
Kapitali i regjistruar (aksionar)	10	31,400,000	31,400,000
Primi i aksionit		-	-
Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
Rezerva statutore		-	-
Rezerva ligjore	10	-	-
Rezerva të tjera	10	35,005	35,005
Fitimet(humbja) te pashpërndara		25,948,797	10,992,619
Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	19,142,684	14,956,178
Totali i Kapitalit (III)		76,526,486	57,383,802
TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		210,053,659	201,515,434

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
 (Të gjitha balancat janë në lekë)

Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2012	Viti raportues 31.12.2011
1 Shitjet neto	11	145,025,741	104,998,487
2 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Punë		41,157,800	
3 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe		-	-
4 Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(138,955,934)	(70,450,419)
5 Kosto e punës	11		
Pagat e personelit		(9,338,441)	(7,711,434)
Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(1,559,516)	(1,287,809)
6 Amortizimet dhe zhvlerësimet		(1,049,936)	(690,771)
7 Shpenzime të tjera		(10,838,721)	(6,087,085)
8 Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		(161,742,548)	(86,227,518)
9 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-)	0	24,440,993	18,770,969
10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11	-	-
12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		(2,953,632)	(1,906,380)
12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		(110,990)	(252,178)
12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-	5,565
13 Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (1		(3,064,622)	(2,152,993)
14 Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)	0	21,376,371	16,617,976
15 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69	12	2,233,687	1,661,798
16 Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)	11	19,142,684	14,956,178
17 Elementët e pasqyrave të konsoliduara		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2012	Viti raportues 31.12.2011
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		21,376,371	16,617,976
Rregullime për:			
Amortizimin		1,049,936	690,771
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Vlera kontabel e AAM-ve të shitura		32,777	-
Shpenzime për interesa		2,953,632	1,906,380
Rritje/rënie në tepicën e kërkesave të arkëtueshme nga a		(10,106,836)	(33,456,899)
Rritje/rënie në tepicën inventarit		18,273,446	(11,860,516)
Rritje/rënie në tepicën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		(25,146,870)	50,859,363
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		8,432,457	24,757,075
Interesi i paguar		(2,953,632)	(1,906,380)
Tatim mbi fitimin i paguar		(1,591,071)	2,056,907
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		3,887,754	24,907,602
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(21,694,130)	(6,913,850)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		(21,694,130)	(6,913,850)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		14,542,412	(8,929,135)
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		14,542,412	(8,929,135)
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		(3,263,965)	5,462,261
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		7,185,502	1,723,241
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		3,921,537	7,185,502

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i regjistruar(aksionar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
A Pozicioni më 31 Dhjetor 2010	31,400,000	-	35,005	10,992,619	42,427,624
Efekti ndryshimeve ne politikat kont	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	31,400,000	-	35,005	10,992,619	42,427,624
Fitimi neto për periudhën kontabël				14,956,178	14,956,178
Dividentët e paguar				-	-
Rritje e rezervës së kapitalit(perov.	-	-	-	-	-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	-	-	-	-	-
B Pozicioni më 31 Dhjetor 2011	31,400,000	-	35,005	25,948,797	57,383,802
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-		19,142,684	19,142,684
Dividentët e paguar	-	-		-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit			-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
C Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	62,800,000	-	35,005	45,091,481	76,526,486

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "3A Profile" sh.p.k dhe jane firmosur nga:

Administratori

Leni GRUDA



3A Profile sh.p.k

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

“3A Profile” sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 9 Mars 2007 dhe gjendet e regjistruar ne regjistrin tregtar (QKR), identifikuar me NIPT-in K71704022V. Kapitali regjistruar aktualisht eshte 31.400.000 leke dhe zotrohet nga ortakët Mirjeta Kurti dhe Leni Gruda.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2012 ka qene kryesisht sherbimet e ndertimit dhe tregtimi i lubrifikanteve.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë,banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese. Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare. Aktivitete financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim,si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivitet financiar

Shoqëria i klasifikon aktivitet financiar në Llogari/Kerkesa te arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitet financiar paraqiten në bilanc me vlerën neto,pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kerkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje

me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2012 janë 1 euro=139.59 leke dhe 1 dollar=105.85 leke.

Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për ti sjelle inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuar me vlerën neto, pra më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes.

Aktivitet afatgjatë materiale

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur. Në ndryshim nga një vit me parë, për vitin 2012 ndertesat amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjatë

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjatë, bazuar në përcaktimet e SKK-2. Huamarrjet afatshkurta njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit)

dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga koston e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2012 është 10 % aq sa ka qene në ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimi e shtyrë.

3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në fund dhe fillim të ushtrimit janë si më poshtë:

Emertimi i Llogarisë	Monedha	Gjendja në 31.12.2012		Gjendja në 31.12.2011	
		Në leke	Në valute	Në leke	Në valute
Llogari bankare	LEK	98,596	0	1,799,526	-
Arka në leke	LEK	3,822,941	0	5,385,976	-
Shuma		3,921,537	x	7,185,502	x

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepërcat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës respektive. (shih shënimin 2)

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel janë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2012	31 Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	34,031,406	57,902,152
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	108,256,844	74,921,880
(iii) Instrumente të tjera borxhi	0	0
(iv) Investime të tjera financiare	0	0
Shuma	142,288,250	132,824,032

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar kerkeat për tu arkëtuar nga klientet për shitjet e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, të cilat nuk janë arkëtuar në fund të ushtrimit dhe huadhenie afatshkurtra të një shoqërie tregtare.

Ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" janë pasqyruar:

- Shteti-tatim mbi vlerën e shtuar.....2.454.355 leke
- Parapagime për blerje materiale.....272.948 leke

Gjithashtu këtu është paraqitur dhe kërkesat debitoare ndaj shoqërisë ASJA sh.a dhe I&A sh.p.k

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rritje në vlerë.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Inventari		
(i) Lëndët e para	28,403,282	39,657,572
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	6,332,981	13,352,137
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	34,736,263	53,009,709

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2012. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares së ponderuar", gjeneruar nga programi "Alpha". Shuma e inventarit të paraqitur në "Lëndët e para" përfaqëson stokun e lendeve të para dhe materialeve ndihmëse që përdoren në procesin e prodhimit dhe tregtimit të vlerësuar me koston mesatare të ponderuar.

Posti "Mallra për shitje" përbehet nga inventari i mallrave të marra nga importi dhe brenda vendit, të destinuar për shitje dhe të vlerësuar me koston mesatare të marrjes.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes koston të marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të tij.

6. Aktivët Afatgjata**Aktivët Afatgjata Materiale(AAM-te)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivët te tjera afatgjata materiale	AAM-ne proces	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2012	4,000,000	-	5,080,397	683,974	-	9,764,371
Shtesat	100,000	-	1,653,445	163,389	19,777,296	21,694,130
Pakesimet	-	-	-	(32,777)	-	(32,777)
Kosto e AAM-ve 31.12.2012	4,100,000	-	6,733,842	814,586	19,777,296	31,425,724
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2012	-	-	1,037,199	230,980	-	1,268,179
Amortizimi ushtrimit	-	-	951,301	98,635	-	1,049,936
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2012	-	-	1,988,500	329,615	-	2,318,115
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2012	-	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2012	-	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2012	4,000,000	-	4,043,198	452,994	-	8,496,192
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2012	4,100,000	-	4,745,342	484,971	19,777,296	29,107,609

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2012. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale (shih shenimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

Gjate vitit 2012 shoqeria ka kryer investime per ndertimin e kompleksit te ri te magazinave ne Komunen Vaqarr dhe vlera e saj eshte 19.777.296 leke

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrijet

Nuk ka hua te klasifikuara afatshkurtera per viti 2012.

Ne postin "Grantet dhe te ardhura te shtyra" eshte pasqyruar shumat e paradhenieve te marra nga Autoritetin Portual Durres ne vitin 2011, me vleren 37.800.944 leke, e paraqitur ne vitin 2011 si e ardhur e shtyre dhe e amortizuar gjate vitit 2012 per shumen 16.985.584 leke, e cila eshte kaluar ne te ardhurat e ushtrimit..Gjendja e mbetur prej 20.815.360 leke do te merret ne te ardhura ne vitin vazhdim.

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2011	31
Huatë dhe parapagimet			
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	79,535,034	87,946,146	
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	750,932	735,866	
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	528,269	293,509	
(iv) Hua të tjera	0	0	
(v) Parapagimet e arkëtuara	0	0	
Shuma	80,814,235	88,975,521	

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht.

Ne "Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" përbehen nga:

- Sigurimet shoqerore e shëndetësore154.690 leke
- Tatimi mbi të ardhurat personale57.289 leke
- Shteti-Tatim mbi fitimin.....316.290 leke

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate dhe parapagimet afatgjata në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2011	31
Huatë afatgjata			
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	31,897,578	17,355,166	
(ii) Bonot e konvertueshme	0	0	
Shuma	31,897,578	17,355,166	

Në këtë post është pasqyruar:

- Overdrafti i marrë në "Intesa San Paulo" sh.a me gjendje më 31.12.2012 ,112.158 Euro ose 15.656.081 leke.
- Overdrafti po nga kjo bankë, "Intesa San Paulo" sh.a, me gjendje më 31.12.2012 16.241.494 leke.

10. Kapitale të veta

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrat financiare është i njëjte me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR. Më 31.12.2012 ai është 31.400.000 leke, i ndarë në 31.400 kuota me vlerë nominale 1.000 leke /kuota.

Më vendim të Asamblesë së Ortakëve fitimi i vitit 2011 dhe rezervat janë destinuar për rritjen e rezervave të kapitalit.

Gjatë ushtrimit kontabel 2012 nuk ka rritje ose pakesim në kapitalin e regjistruar të shoqërisë dhe në raportet zoterimit nga ortakët.

11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2012	Viti raportues 31.12.2011
Te ardhurat		
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0	0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	122,038,086	104,998,487
Te ardhurat nga shitja e mallrave	24,101,578	
Pridhim I AAM-ve	19,777,296	
Te ardhurat te tjera	20,266,581	0
Shuma	186,183,541	104,998,487

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

Per vitin 2012 nepermjet FDP-ve mujore kemi deklaruar qarkullimin vjetor ne vleren 169.198.221 leke. Përvec kesaj shume, ne te ardhurat e pasqyruara ne PASH eshte shtuar dhe shuma e te ardhurave te marra nga "Grantet dhe te ardhura te shtyra", te deklaruar ne vitin 2011 dhe qe ka lidhje me kontraten qe kompania ka me Autoritetin Portual Durres te lidhur ne muajin Korrik te vitit 2011.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2012 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Ne zerin "Shpenzime te tjera" pasqyruar ne piken 7 te Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve analizohen si vijon:

Shpenzime te tjera		
Telefoni, internet	739,752	733,547
Qera	240,000	300,000
Sherbime nga te tretet	8,417,492	280,222
Sherbime bankare	273,578	225,597
Tatime, taksa dhe derdhje te ngjashme	174,620	66,120
Shpenzime te tjera rrjedhese	993,279	448,159.06
Shuma	10,838,721	6,087,085

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

▪ Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2012 (000 leke)			Ushtrimi 2011 (000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi
Administrator, menaxher	1	1,009	149	1	1,009	149
Specialist me arsim universitar	2	864	144	-	-	-
Teknike	6	2,714	453	4	2,016	337
Puntor	17	4,750	812	18	4,715	806
Shuma	26	9,338	1,559	23	7,740	1,292

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2012 dhe 2011 jane si vijon:

	Viti raportues 31.12.2012	Viti raportues 31.12.2011
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	21,376,371	16,617,976
II SHPENZIME TE PAZBriteshme (+)	960,502	-
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	960,502	-
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera-interesa bankare	-	-
III PJESA E HUMBjes SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	22,336,873	16,617,976
V Shpenzimi i tatim fitimit-10%	2,233,687	1,661,798
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	19,142,684	14,956,178

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2012 eshte rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar. Raportet e rentabilitetit per vitin 2012 jane: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) dhe tatim fitimit eshte 13.3%, ndersa fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 11.48 %.

15. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2011 jane te njejta me ato te prezantuara ne vitin aktual 2012.